

Ne angazhohemi me përgjegjësi në  
mediat sociale

---

# Politika për Mediat Sociale për punonjësit

Qershor 2025

V2.1

## Përmbajtja

|                                                                                                            |          |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|
| <b>Si të mbron veten dhe TITAN-in në internet</b>                                                          | <b>3</b> |
| <b>Komunikimi ka ndryshuar</b>                                                                             | <b>3</b> |
| Mediat sociale po ndryshojnë mënyrën se si të gjithë bashkëveprojmë dhe ndajmë informacione                | 3        |
| <b>Disa gjëra për t'i mbajtur mend</b>                                                                     | <b>3</b> |
| Jetësimi i vlerave të TITAN-it                                                                             | 3        |
| Çdo gjë që postoni është publike dhe do të mbetet aty përgjithmonë                                         | 3        |
| Askush nuk është anonim në internet                                                                        | 3        |
| Kini kujdes për detajet personale                                                                          | 3        |
| Mos harroni: ligji ende zbatohet                                                                           | 3        |
| <b>Ndarja e informacionit rreth TITAN-it në mediat sociale</b>                                             | <b>3</b> |
| Respektoni privatësinë e kolegëve, partnerëve dhe klientëve                                                | 3        |
| Mbron gjithmonë informacionin e kompanisë                                                                  | 4        |
| Kërkoni nga partnerët e jashtëm të mbrojnë informacionin e kompanisë sonë                                  | 4        |
| Ngarkimi i fotografive dhe videove për TITAN-in? Mendohuni dy herë, pastaj mendoni përsëri                 | 4        |
| <b>Përfaqësimi i TITAN-it në mediat sociale</b>                                                            | <b>4</b> |
| Vetëm zëdhënësit e autorizuar të TITAN-it mund ta përfaqësojnë zyrtarisht kompaninë në publik ose në media | 4        |
| Nëse shihni referenca negative për TITAN-in në mediat sociale                                              | 4        |
| TITAN përpiqet vazhdimisht të krijojë një vend pune që respekton të drejtat e çdo njeriu                   | 4        |
| Përdorimi i platformave të mediave sociale gjatë orarit të punës                                           | 4        |
| <b>Kanalet e mediave sociale të Grupit TITAN</b>                                                           | <b>4</b> |
| <b>Gjashtë këshillat kryesore të TITAN-it për mediat sociale</b>                                           | <b>5</b> |

## Si të mbroni veten dhe TITAN-in në internet

Ndikimi gjithnjë në rritje i mediave sociale është diçka që çdo biznes duhet ta trajtojë. Në TITAN ne dëshirojmë që ta zbatojmë një qasje të qëndrueshme. Për këtë arsye po i ofrojmë këshillë të gjithëve në TITAN se si të përdoren këto platforma në një mënyrë që e mbron brendin, identitetin dhe reputacionin e kompanisë TITAN (dhe të gjitha degëve të saj). Ky është qëllimi i kësaj politike.

Ajo gjithashtu jep udhëzime të qarta për çështje të tilla si privatësia, mbrojtja e informacionit të kompanisë, ngarkimi i përmbytjeve dhe krijimi i profileve në mediat sociale. Duke zbatuar këtë politikë, ju do të jeni në gjendje që në mënyrë të besueshme dhe të sigurt të përdorni mediat sociale dhe forumet në internet dhe në të njëjtën kohë do të jeni në nivel të përgjegjësive tuaja si punonjës të TITAN-it.

## Komunikimi ka ndryshuar

### Mediat sociale po ndryshojnë mënyrën se si të gjithë bashkëveprojmë dhe ndajmë informacione

Nëse i përdorni faqet e mediave sociale, të tilla si Facebook, Twitter ose YouTube, ose rregullisht kontribuoni në forumet e internetit, ju po merrni pjesë në një formë komunikimit relativisht të pamoderuar. Dhe derisa këto faqe mund të ofrojnë përvoja interesante dhe argëtuese, janë disa pika të cilat ju duhet t'i merrni parasysh. Në veçanti, ju sugjerojmë që t'i shmangeni krijimit të faqeve ose grupeve që kanë të bëjnë me TITAN-in pa autorizimin zyrtar të kompanisë.

## Disa gjëra për t'i mbajtur mend

### Jetësimi i vlerave të TITAN-it values

Në të gjitha komunikimet, përpiquni të jeni të respektueshëm ndaj të tjerëve ashtu siç bëni në punë, madje edhe kur TITAN nuk është temë diskutimi.

Sjelljet e mira janë po aq të rëndësishme në mediat sociale sa edhe kudo tjetër. Prandaj, jini të sjellshëm, dëgjoni pikëpamjen e të tjerëve dhe përpiquni të shmangni mendimet e pandjeshme. Për udhëzime, duhet ta merrni parasysh Kodin e Mirësjelljes së TITAN-it.

### Çdo gjë që postoni është publike dhe do të mbetet aty përgjithmonë

Nëse doni të ngarkoni një fotografi, film ose shaka argëtuese ose madje vetëm një shënim, ja vlen të merrni parasysh disa gjëra paraprakisht. A është ndokush që e njihni e që mund të ofendohet? A jeni komod me faktin që mesazhi juaj do të qëndrojë aty për një kohë të gjatë? Nëse keni dyshime, mos e postoni.

### Askush nuk është anonim në internet

Madje edhe nëse përdorni ndonjë nofkë ose email të falsifikuar, çdo postim len gjurmë. Prandaj, sigurohuni që kontributet tuaja të jenë pozitive dhe të kenë pasqyrim të mirë për ju dhe TITAN-in.

### Kini kujdes për detajet personale

Është ide e mirë që të keni kujdes me shkëmbimin e të dhënave tuaja personale kur të jeni në internet. Prandaj, shfrytëzoni kohën për të mësuar për konfigurimin e privatësisë në ndonjë kanal të mediave sociale të cilin e përdorni ashtu që të jeni të sigurt.

### Mos harroni: ligji ende zbatohet

Kur përdorni mediat sociale ose forumet e internetit, duhet t'i respektoni ligjet, rregullat dhe standardet e njëjta që vlejné për format e tjera të komunikimit.

## Ndarja e informacionit rreth TITAN-it në mediat sociale

### Respektoni privatësinë e kolegëve, partnerëve dhe klientëve

Remember that social media is a form of publishing and most people would prefer not to be represented without their knowledge.

## Mbroni gjithmonë informacionin e kompanisë

Mbani mend se media sociale është një formë e publikimit dhe shumica e njerëzve do të preferonin mos të përfaqësoheshin pa njohurinë e tyre.

## Kërkoni nga partnerët e jashtëm të mbrojnë informacionin e kompanisë sonë

Është e rëndësishme të informojmë partnerët tanë të jashtëm se nuk duhet të ndajnë asnjë informacion ose dokument në lidhje me partneritetin dhe bashkëpunimin e tyre me TITAN-in në profilet e tyre në mediat sociale pa lejen e TITAN-it. Kërkoni nga ta t'iu pyesin përpara se të ndajnë ndonjë gjë. Kontaktoni menaxherin e autorizuar të vendit tuaj ose departamentin e Komunikimeve Korporative të Grupit TITAN, nëse keni nevojë për konsultim.

## Ngarkimi i fotografive dhe videove për TITAN-in? Mendohuni dy herë, pastaj mendoni përsëri

Kini kujdes kur ngarkoni fotografi/video që lidhen me punën ose materiale të tjera që nuk janë nga kanalet zyrtare të komunikimit të kompanisë, pa lejen e menaxherit të autorizuar të vendit tuaj ose përfaqësuesit të departamentit të Komunikimeve Korporative të Grupit TITAN.

## Përfaqësimi i TITAN-it në mediat sociale

### Vetëm zëdhënësit e autorizuar të TITAN-it mund ta përfaqësojnë zyrtarisht kompaninë në publik ose në media

TITAN ka një ekip të përkushtuar për përfaqësimin e kompanisë dhe trajtimin e ndonjë krize. Nëse e gjeni veten të përfshirë në biseda që ndërlidhen me TITAN-in, gjithmonë tregoni lidhjen tuaj me kompaninë.

Gjithashtu duhet ta bëni të qartë që mendimet tuaja janë tuajat dhe jo të kompanisë.

### Nëse shihni referenca negative për TITAN-in në mediat sociale

Ju lutemi informoni menaxherin e autorizuar për vendin tuaj, ose përfaqësuesin e departamentit për Komunikime Korporative të Grupit TITAN.

Mund të ketë raste kur kompania duhet të jep një përgjigje zyrtare. Prandaj, ju lutemi ta raportoni posa ta keni parë. (Keni parasysh: jo të gjitha rastet kanë nevojë për një përgjigje zyrtare).

### TITAN përpiqet vazhdimisht të krijojë një vend pune që respekton të drejtat e çdo njeriu

Megjithatë, nuk mund të kontrollojmë çdo gjë që ndodh në mediat sociale. Prandaj, nëse shihni hasni sjellje në mediat sociale që nuk do të ishin të pranueshme nga TITAN ju sugjerojmë që të çkyqeni. Në rastet ku përfshihet abuzimi, duhet të merrni në konsideratë raportimit të tij te ofruesi i shërbimit.

Gjithashtu, nëse hasni sjellje të pahijshme në mediat sociale, e që besoni që ndërlidhen me punë, ju lutemi ta njoftoni kompaninë lidhur me të.

### Përdorimi i platformave të mediave sociale gjatë orarit të punës

Aktiviteti i mediave sociale nuk duhet të ndërhyjë në realizimin e suksesshëm të detyrave tuaja të punës në TITAN.

## Kanalet e mediave sociale të Grupit TITAN

Kanalet e mediave sociale të Grupit TITAN, të cilat mund t'i ndiqni dhe gjithashtu t'i ndani me partnerët dhe klientët tuaj, janë:

- Faqja e Grupit TITAN në LinkedIn:
  - Emri: TITAN Cement Group
  - Url: [TITAN Group: Posts | LinkedIn](#)

- Kanali i Grupit TITAN në YouTube:
  - Emri: TITAN Cement Group
  - Url: [TITAN Group - YouTube](#)

## Gjashtë këshillat kryesore të TITAN-it për mediat sociale

- Eksploroni dhe argëtoheni në mediat sociale, por gjithmonë mbani mend përgjegjësitë tuaja dhe qëndroni të sigurt.
- Përdorni logjikën e shëndoshë dhe zbatoni standardet e njëjta për postimet tuaja online sikurse do të bënit me të gjitha komunikimet tjera.
- Kujdesuni që t'i shmangeni postimit të ndonjë gjëje që është konfidenciale ose e ndjeshme për TITAN-in, punonjësit, partnerët ose klientët e tij.
- Mos krijoni profile të mediave sociale që ndërlidhen me TITAN-in pa leje.
- Nëse shihni që TITAN po diskutohet në mediat sociale, informoni personat e duhur.
- Bota është e vogël dhe ne jemi një kompani globale. Mbani mend që ajo çfarë thoni mund të shihet nga klientët dhe punonjësit në tërë botën dhe diçka që thoni në një shtet mund të jetë e pasaktë ose ofenduese në një shtet tjetër.

**TITAN është pronar i të gjitha të drejtave, titujve dhe interesave në dhe lidhur me markat tregtare, logon, emrin TITAN dhe për të gjitha markat tregtare, logot dhe emrat e regjistruara në emër të kompanive të Grupit TITAN në tërë botën si dhe emrin e mirë (goodwill) të bashkëngjitur ose që do të bashkëngjitet dhe se punonjësit nuk kanë ndonjë të drejtë, titull ose interes në markat tregtare, logot dhe emrat e TITAN.**